08.10.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA
MARRË NË DOREZIM-PRIMLJENO-RECEIVED

Njësia org. Org. Jedinica Org. Untt	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	104	50803	8

Për: Komisionin për shqyrtimin e propozimeve për ndarjen e çmimit "Ukë BYTYÇI"

Nga : Kryetari i Komunës –Bali MUHARREMAJ

Lënda: Propozim

Me anë të kësaj shkrese kërkojmë nga Ju te nderuar që z. **Gani Fejzullah BERISHA** ti ndahet çmimi "Ukë BYTYÇI" për **Udhëheqje të mirë,** në sektorin privat.

Bashkangjitur me këtë shkresë keni; Biografinë dhe civin:

Mbesim me shpresë se propozim jonë do të hasë në mirëkuptim.

Me datë 07.10.2026

Me respekt

Propozuesi
Bali MUHARREMAJ

Gani Fejzullah Berisha

I lindur me 15.04.1966 ne Suharekë.
Shkollen fillore ne Suharekë dhe shkollen e mesme për gjeodozi dhe kadaster në Shkollën e mesme teknike në Prizren.

Rrjedh nga një familje me aktivitet politik dhe Kombëtar që nga brezat e mëhershme nga të dya anët e pararadhësve.

Për shkak të situatës më së të ditur të kohës si 18 vjeçar merr rrugën e mërgimit dhe migron në shtetin e Zvicrës, ku me punë dhe përkushtim përveq ndihmës për familjarët në Kosovë ai ndihmoi edhe shumë mergimtar tjerë nga që në fillimet e tyre perveç që ti orientoj në përshtatjen e tyre me jetën dhe punën në Zvicër gjithashtu ti siguroj vendamin në banesën e tij.

Gjithashtu shumë e rëndësishme të theksohet se që nga fillimi i viteve 90'ta me fillimin e intensifikimit të përpjekjeve për qështjet kombëtare lidhur me Lirinë e Kosovës, Ganiu ishte pjesëmarrës në shum aktivitete të organizatave politko-financiare të kohës të kohës ku përveç aktivitetit, përfshirë edhe donacione financiare për aktivitetet që zhvilloheshin ne Kosovë.
Pas çlirimit të Kosovës ishte donator ne shum fusha për zhvillim dhe rindërtim duke i nidhmuar familjeve me nevoj gjithashtu edhe donatorë tek Shoqata "Nëna Terezë" ne Suharekë, duke siguruar nga Zvicra mjete për përdorim nga personat e Hendikepuar.

Pas shumë viteve punë dhe angazhim në vitin 2013, Themeloi Kompaninë e tij tani me renome ne Shtetin e Zvicrës "GANITRANSPORT" me Seli ne Cyrih të Zvicrës dhe me filial në Suharekë ku sot kjo Kompani numëron shumë të punësuar nga Komuna jonë.

Kompania që ai themeloj gjithmonë dhe pa hezitim është ndër Kompanitë e Komunës sonë të cilat ne fusha të ndryshme duke përfshirë, Kulturë, Sport, infrastrukturë, raste për nevojë të ndihmës sociale, pa hezitim kontribon në të mirë të komunitetit.